



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE**

**VENDIM**

**NR. 17, DATË 21 / 11 /2024**

**PËR MOSPRANIM TË KËRKESËS PËR PËRFITIM TË STATUSIT**  
**“INVESTIM/INVESTITOR STRATEGJIK PROCEDURË E VEÇANTË” PËR**  
**PROJEKTIN E INVESTIMIT “TIRANA NORTH PARK-FREE ECONOMIC ZONE**  
**LAPRAKË” ME SUBJEKT APLIKUES**  
**TIRANA NORTH PARK FREE ECONOMIC ZONE SHPK NUIS M32415030M**

Në mbështetje të nenit 9, nenit 13, nenit 17 pika 5, nenit 18 dhe nenit 22 të Ligjit Nr. 55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit nr. 9789, datë 19.07.2007 “Për Krijimin dhe Funksonimin e Zonave të Teknologjisë dhe Zhvillimit Ekonomik” ndryshuar me Ligjin nr. 54/2015 “Për Disa Ndryshime dhe Shtesa në Ligjin nr. 9789, datë 19.7.2007, “Për Krijimin dhe Funksonimin e Zonave të Teknologjisë dhe Zhvillimit Ekonomik”, Kreut II, pika 8 dhe 10 e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 1026, datë 16.12.2015 “Për vlerësimin e dokumentacionit të investimeve strategjike”, Komiteti i Investimeve Strategjike, me propozim të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA),

**VLERËSOI SE:**

- Projekti i investimit parashikon krijimin e një Zone Teknologjike dhe e Zhvillimit Ekonomik (TEDA), në të cilën do të zhvillohen industritë si ICT, elektronike, farmaceutike, industria prodhuese, industria agropërpunuese, zonë logjistike mallrash dhe hapësira për nomadët digjitalë.
- Projekti i investimit synon të zhvillohet në dy zona kryesore sipas funksionit të regjimit doganor në zonë të lire ekonomike – logjistike dhe industrial dhe zonën miks

të parkut teknologjik me përzierje të tipologjive “retail”, zyra, data center, kampus universitar, në zonën kadastrale ZK 8310, Laprakë, Bashkia Tiranë.

- Projekti propozohet të realizohet nga Tirana North Park Free Economic Zone shpk me NUIS M32415030M.
- Vlera e investimit për projektin e propozuar parashikohet të jetë 119,995,959 (njëqind e nëntëmbëdhjetë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e nëntë) Euro dhe numri i të punësuarve parashikohet të jetë nga 1200-6000 (një mijë e dyqind deri në gjashtë mijë) punonjës.
- Projekti i propozuar shtrihet në një sipërfaqe prej 10,9 ha, në pronësi “private” të subjektit propozues dhe në pronësi “shtet” me objekte private të ndërtuara mbi to.

Në përfundim, pasi u njoh me gjithë dokumentacionin e nevojshëm,

## **KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE**

### **VENDOSI:**

1. Mospranimin e kërkesës për përfshirjen e projektit investues “Tirana North Park - Free Economic Zone Laprakë”, me subjekt investues “Tirana North Park Free Economic Zone” shpk me NUIS M32415030M, ZK 8310, Laprakë, Bashkia Tiranë në procedurën e veçantë dhe mbështetjen që ofron ky status.
2. Për zonën prej 4,69 ha në ZK. 8310, në pronësi shtet, për të cilën kërkohet masa mbështetëse e vendosjes në dispozicion të kësaj pasurie shtetërore, rezulton se ka një sërë aktesh ligjore të mbivendosura që e prekin në mënyrë direkte situatën juridike të pronës.
3. Vendimi i Komitetit të Investimeve Strategjike publikohet dhe regjistrohet në Regjistrin e Investimeve Strategjike dhe i njoftohet kërkuarit nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, në rolin e saj të Sekretariatit të Komitetit të Investimeve Strategjike.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE  
KRYEMINISTËR**

EDI RAMA

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**

**MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË**

BELINDA BALLUKU

**MINISTËR I EKONOMISË KULTURËS DHE INOVACIONIT**

BLENDI GONXHJA

**MINISTËR I FINANCAVE**

PETRIT MALAJ

**MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT**

MIRELA KUMBARO

**MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL**

ANILA DENAJ

**AVOKATI I PËRGJITHSHËM I SHTETIT**

ODISE MOÇKA

**SEKRETARIATI TEKNIK I KIS  
LAURA PLAKU (SARO)**